



International Observation Mission to Kosovo Municipal Elections 2009	
Misioni Ndërkombëtar i Vëzhgimit në Kosovë për Zgjedhjet komunale 2009	Međunarodna posmatračka misija - Lokalni izbori na Kosovu 2009

DEKLARATA E GJETJEVE DHE PËRFUNDIMEVE PRELIMINARE PËR RAUNDIN E DYTË TË ZGJEDHJEVE PËR KRYETAR KOMUNE

**Raundi i dytë i Zgjedhjeve për Kryetar Komune në Kosovë
tregon Përmirësime të Dukshme;**

Sidoqoftë, Sfidat Mbesin

Prishtinë, 14 dhjetor, 2009

Misioni vëzhgues ndërkombëtar i Rrjetit Evropian të Organizatave për Monitorimin e Zgjedhjeve (ENEMO) ka vëzhguar procesin zgjedhor në Kosovë që nga fillimi i tetorit 2009. ENEMO ka lëshuar deklaratën e parë preliminare me 16 nëntor 2009 dhe një deklaratë të përkohshme me 9 dhjetor (të dyja mund të gjenden në www.enemo.eu). Deklarata në vijim pasqyron vrotimin që i ka paraprirë raundit të dytë të zgjedhjeve për kryetar komune me 13 dhjetor, si dhe vetë Ditën e Zgjedhjeve. Misioni do të mbes në Kosovë për të vëzhguar procesin e numërimit dhe do të publikoj një raport përfundimtar në janar 2010. Për më tepër informata lidhur me metodologjinë vëzhguese, ju lutemi të shikoni në fund të këtij dokumenti.

Përfundimet preliminare

- **Procesi i thjeshtësuar në raundin e dytë të zgjedhjeve për kryetar komune, së bashku me përpjekjet e Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) kanë rezultuar në një përmirësim të vogël në ndërmarrjen e procedurës së votimit, dhe në veçanti, në një proces efikas të numërimit dhe pranimit.**
- **Raundi i dytë i zgjedhjeve për kryetar komune kanë filluar derisa rezultatet për kuvende komunale ende nuk janë certifikuar. Për shkak të faktit se ankesat lidhur me alokimin e kandidatëve për kuvend ende janë në procesin e gjyqimit, gjatë raundit të dytë të zgjedhjeve me 13 dhjetor Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) është përballur me sfida në përgatitjen për raundin e dytë.**

- Fushata zgjedhore në përgjithësi ka qenë e qetë ku aktorët politikë janë përqendruar në aktivitetet derë-më derë.
- Pas anulimit nga KQZ dhe Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (KZAP) të disa vend votimeve si rezultat i parregullsive të shkaktuar nga stafi i vend votimeve në raundin e parë, KQZ ka zëvendësuar një numër të madh të stafit të Komisionit për Vend Votime (KVV). Shumë kërkesa për ndërrimin e stafit votues gjithashtu janë bërë nga entitetet e ndryshme politike.
- Misioni ENEMO shpreson se rastet e zbuluara të mashtrimit në raundin e parë të zgjedhjeve komunale do të hetohen dhe përpunohen nga autoritetet përkatëse.
- Përdorimi i përgjithësuar i votimit me kusht i shtohet sfidave dhe shpenzimeve të procesit zgjedhor. Ato shtohen edhe më tepër nga votimet jashtë vendit, një koncept i pazakonshëm për zgjedhjet Komunale dhe për Kryetar të Komunave.
- Shumë deklaratatë të mashtrimit dhe manipulimit nga shumica e partive, shpesh të bëra pa konsideratë ndaj mekanizmave ligjor dhe institucional të nevojshme për zgjidhjen e ankesave, kanë krijuar një atmosferë të tensionuar në të cilën legjitimiteti i rezultateve zgjedhore mund të sfidohet.
- Mbështetja e vazhdueshme në ndihmën ndërkombëtare për organizimin e zgjedhjeve ka ngritur shqetësime rreth gatishmërisë për ndërtimin e kapaciteteve brenda institucioneve përkatëse.
- Përkundër kornizës ligjore e cila promovon barazinë gjinore si “një vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë,” pjesëmarrja e grave në institucionet politike dhe shtetërore të Kosovës mbetet e kufizuar.
- Prania e gjerë e votimit familjar, që është vrojtuar, jo vetëm që është kundër ligjit por paraqet një shkelje serioze të parimit të rëndësishëm të fshehtësisë së votës. Në përgjithësi, pranimi i dukshëm i kësaj shkelje nga autoritetet zgjedhore dhe vëzhguesve partiak edhe më tej konsolidon një traditë të përjashtimit të grave nga luajtja e rolit aktiv në shoqëri.
- Një numër i aktorëve brenda institucioneve publike vazhdojnë të mos përfillin parimin themelor të mos shfrytëzimit të burimeve publike për fushatat politike
- Mungesa e komunës së Prishtinës në raundin e dytë ka nënkuptuar se mbulimi medial i garave të ndryshme ka qenë i shpërndarë në mënyrë më të barabartë në krahasim me raundin e parë.

Historiku

Pas publikimit të rezultateve përfundimtare për kryetar komune të raundit të parë me 26 nëntor 2009, Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ) ka shpallur se një raund i dytë i zgjedhjeve për kryetar komune do të ishte e nevojshme për vendosjen e garës në 21 komuna. Sipas ligjit¹ data për raundin e dytë është caktuar për 13 dhjetor.

Korniza Ligjore

Në pajtim me Rregullin Zgjedhor 10/2009 të KQZ-së, raundi i dytë i zgjedhjeve për kryetar komune është mbajtur në kuadër të kornizës së njëjtë ligjore sikurse gjatë raundit të parë me 15 nëntor. Dallimet praktike për raundin e dytë përcaktohen në të njëjtin rregull.

Administrimi zgjedhor

Raundi i dytë i zgjedhjeve për kryetar komune kanë filluar edhe pse rezultatet për kuvende komunale ende nuk ishin certifikuar. Shpallja e vonshme dhe certifikimi i rezultateve përfundimtare ka qenë pasojë e gabimeve në paketim dhe mbledhjeve në tabelë të bëra në nivel të vend votimeve, që më vonë janë zbuluar në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR).

KQZ-ja është përgjegjëse për QNR-në, ku bëhet numërimi i votave me kusht dhe të atyre me nevoja speciale, si dhe të atyre të dërguar me postë nga jashtë Kosova. QNR gjithashtu auditon materialin dhe formularët që arrijnë nga vend votimet përmes komisioneve komunale zgjedhore (KKZ). QNR është pjesë e procesit zgjedhor që merr kohë dhe shpenzime- pjesërisht për shkak të përdorimit të përgjithësuar të votave me kusht.

Për shkak të faktit se ankesat lidhur me alokimin e kandidatëve për kuvend komunal kanë qenë ende në proces të gjykimit gjatë zgjedhjes me 13 dhjetor, QNR është përballur me sfida në përgatitjen e raundit të dytë.

Gjatë këtyre gjykimeve të bëra nga KZAP dhe KQZ, rastet e sjelljes së dyshimtë për mashtrim të bëra në vend votime janë zbuluar dhe kanë rezultuar në pavlefshmëri të rezultateve të vend votimeve. Besueshmëria e KQZ, si dhe zgjedhjet e ardhshme, do të përforcohen nëse veprimet e deklaruara për mashtrim do të hetoheshin nga autoritetet përkatëse. Çdonjëri që është zbuluar të ketë kryer krim lidhur me zgjedhjet duhet të ndiqet penalisht. Shembulli fatkeq i zgjedhjeve të vitit 2007 nuk duhet të përsëritet. (Me 20 mars 2008, KZAP i ka dërguar gjetjet e parregullsisve zgjedhore gjatë zgjedhjeve të vitit 2007 në Zyrën e Prokurorit Publik për hetime të mëturshme. Deri më sot, asnjë nga këto raste nuk është hetuar²).

KQZ, që për herë të parë ka qenë përgjegjëse për procesin zgjedhor, ende është vërejtur të jetë e varur në ndihmën teknike ndërkombëtare. Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim (OSBE) ka luajtur një rol të rëndësishëm këshillëdhënës si në nivel qendror ashtu edhe në terren.

Menaxhimi i aspekteve të tilla vendimtare të procesit siç janë Qendra e Numërimit dhe Rezultateve, edukimi i votuesit, dhe votimi në komunat me shumicë etnike të serbëve kosovar në Veri, kanë qenë përgjegjësi e KQZ dhe implementimi i tij teknik është koordinuar nga Fondacioni Ndërkombëtar për Sisteme Zgjedhore (IFES) përmes një marrëveshje të nënshkruar të bashkëpunimit. Kur problemet dhe sfidat e bënë evidente, dukej sikurse KQZ u tërhoq nga roli i udhëheqësit dhe i la IFES-it shumicën e përgjegjësive.

Sikurse edhe në raundin e parë, përgatitjet dhe logjistika nga niveli qendror duket të jenë zbatuar pa ndonjë pengesë të madhe. Mangësitë e vërejtura në terren gjatë raundit të parë me 15 nëntor kanë shpie në një numër të ndryshimeve në përgatitjen e raundit të dytë. Si KKZ-të ashtu edhe entitetet politike kanë vendosur ti ndërrojnë gjithsej 785 komisionarë të vend votimeve për raundin e dytë. KQZ-gjithashtu ka organizuar trajnime shtesë për KKZ-të dhe stafin e komisionit të vend votimeve (KVV).

Anëtarët e KQZ-së, KKZ-ve dhe KVV-ve, me përjashtim të krerëve të KQZ-së dhe KKZ-ve, janë përzgjedhur nga entitetet politike, sikurse përcaktohet me Kushtetutë dhe Ligjin mbi Zgjedhjet e Përgjithshme. Duket se varësia në nominimin nga entitetet politike krijon sfida më të mëdha për procesin sesa nëse përzgjedhja do të ishte bazuar në edukim dhe përvojë profesionale.

Ndryshe nga raundi i parë, votat e dërguara me postë nuk u janë dërguar votuesve jashtë Kosovës për raundin e dytë. Nga qytetarët kosovar që jetojnë jashtë vendit thjesht është kërkuar ti shkarkojnë fletëvotimet nga interneti dhe të votojnë nga jashtë vendit duke iu përmbajtur procedurave të votimit me postë.

KQZ-ja duhet të lavdërohet për përpjekjen e saj në ofrimin e Udhëzimeve mbi Fletëvotimet e Prekshme për njerëzit me pengesa pamore dhe të verbrit që kanë dëshiruar të votojnë pa ndihmë. Edhe pse nuk ka qenë e pranishme në të gjitha vend votimet e vizituara, kjo përpjekje ka kontribuar në respektimin e fshehtësisë së votës.

Fushata

Sipas mandatit të tij³, që i mundëson KQZ-së të vendos për kohëzgjatjen e periudhës së fushatës për raundin e dytë, me 18 nëntor KQZ-ja vendosi që fushata zgjedhore për raundin e dytë të kufizohet në një periudhë prej shtatë ditë, prej 5 dhjetor deri me 11 dhjetor. Edhe pse disa aktorë kanë ndjerë se kjo periudhë ka qenë pa nevojë e shkurtë, kjo i ka dhënë KQZ-së kohë të shpall garuesit në raundin e dytë, ndërsa aktorët tjerë kanë qenë të lumtur të kufizojnë fushatën për të zvogëluar shpenzimet e fushatës.

Para fillimit të fushatës, shumica e aktiviteteve politike është përqendruar në krijimin e aleancave në komuna të ndryshme për ti fituar përkrahësit e kandidatëve që më nuk ishin në garë. Marrëveshjet në mes të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dhe Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) për krijimin e aleancës kundër Partisë Demokratike të

Kosovës (PDK) në disa komuna ka rezultuar në një krizë në koalicionin qeverisës të Kosovës, dhe edhe pse udhëheqësit e dy partive kanë deklaruar se koalicioni është i qëndrueshëm dhe kanë thënë se ndonjë ristrukturim do të mund të ndodhte vetëm pas raundit të dytë të zgjedhjeve për kryetar komune, thashethemet e krizës pa dyshim kanë ngritur temperaturën në fushatën zgjedhore.

Udhëheqësit e partive kanë qenë shumë aktiv në udhëtimin përgjatë Kosovës për përkrahjen e kandidatëve të tyre lokal në tubime dhe takime të ndryshme duke theksuar rëndësinë e zgjedhjeve lokale për ardhmërinë politike të Kosovës në nivel kombëtar. Në të njëjtën kohë, numri i tubimeve dhe takimeve të përmasave të mëdha ka rënë në masë të madhe në krahasim me raundin e parë dhe vetëm disa reklama të reja janë parë në tabelat e reklamave. Grupet politike të interesit në përgjithësi kanë shpjeguar se kanë ndjerë se programi i tyre politik tanimë ka qenë i njohur për votuesit dhe prandaj janë përqendruar në fushatat derë-më-derë dhe vizitat tjera të shkallës së ulët të elektoratit për ti inkurajuar të dalin dhe të votojnë.

Shpërdorimi i burimeve publike (një shkelje e njërës nga parimet themelore të ligjit zgjedhor⁴) tanimë i vërejtur në raundin e parë ka vazhduar gjatë fushatave për raundin e dytë. Automjetet e qeverisë ose komunave në disa raste janë përdorur për takime të fushatës, si dhe për shpërndarjen dhe vendosjen e materialeve zgjedhore.

Media

Diskutimet rreth legjitimitetit të shpalljes së pavarësisë së Kosovës kanë dominuar mediat në mes të dy raundeve zgjedhore. Mirëpo, politikat e partive gjithashtu kanë mbushur pjesën më të madhe të hapësirës së mediave. Deklarimet dhe rrëfimet e vrasësve politik që nga konflikti në Kosovë dhe aleancat lokale që kërcënonin koalicionin qeverisës kanë qenë në fokus të shumë debateve dhe artikujve në media.

Mungesa e komunës së Prishtinës në raundin e dytë ka nënkuptuar se mbulimi i garave të ndryshme është shpërndarë në mënyrë më të barabartë, në krahasim me raundin e parë, kur debati mbi garën kryesore ka dominuar kanalet e mediave.

Prapë, një numër i debateve janë organizuar në media të ndryshme, dhe prania e vetëm dy kandidatëve në secilën garë ka lehtësuar vendim-marrjen e votuesve.

Komisioni i Pavarur i Mediave, (KPM) ka detyrën e monitorimit të mediave gjatë fushatës⁵. KPM-ja gjithashtu ka ndërmarrë të publikoj raportet dy-javore të bazuar në këtë monitorim. Në raportin e parë dy-javor⁶ lidhur me mediat në fushatë, i cili është publikuar me 6 nëntor dhe ka mbuluar javën e parë të fushatës, KPM-ja ka ardhur në përfundim se transmetuesit e mediave kryesisht kanë vepruar në pajtim me ligjin. Për më tepër thuhej se, edhe pse ligji kushtëzon përgjegjësinë e KPM-së lidhur me kanalet e mediave, puna e KPM-së është e kufizuar në mbulimin e mediave transmetuese, duke e lënë kontrollin e mediave të shkruara pa ndonjë organ rregullativ- një zbrazëtirë në legjislacion që, sipas KPM-së “mbetet për diskutim dhe procedim të mëtejme pas zgjedhjeve.”

Që nga ky raport dy-javor, dhe përkundër emrit të tij, asnjë raport apo raport shtesë mbi fushatën nuk është publikuar në ueb faqen e KPM-së, edhe pse media të ndryshme përmendin një raport të ri pak para raundit të dytë të zgjedhjeve. Për më tepër, sipas burimeve në KPM, katër ankesa zyrtare ndaj mediave transmetuese janë dorëzuar. Nga këto, dy janë zgjidhur përmes sqarimeve të lëshuara nga kanalet e mediave për ankuesit, ndërsa dy ankesat tjera ende mbesin të pavendosura gati një muaj pas dorëzimit të tyre.

Në Ditën e Zgjedhjeve, një numër i kandidatëve partiak dhe/ose përfaqësuesve janë intervistuar në programe të ndryshme të debateve në mediat transmetuese. Edhe pse ata në përgjithësi janë pyetur të komentojnë mbi procesin, ata shpesh shfrytëzonin rastin jo vetëm ti nxisin votuesit të dalin dhe të votojnë por edhe të votojnë për partitë e tyre, duke shkelur heshtjen zgjedhore.

Në intervistat e përmendura më lartë, gjithashtu ka pasur shumë deklarime nga të gjitha anët rreth veprimeve të ndryshme të mashtrimit dhe manipulimit në emër të partive tjera gjatë procesit zgjedhor. Derisa misioni fuqimisht nxit të gjithë aktorët ti dëshmojnë këto deklarime dhe ti adresojnë ato te autoritetet e duhur (KZAP dhe shërbimi policor), ato padyshim ngritin shqetësime rreth nivelit të kulture politike demokratike të entiteteve politike. Nëse këto deklarime janë të vërteta (në disa shembuj vëzhguesit e ENEMO kanë qenë dëshmitarë), atëherë veprimet e përshkruara tregojnë një mosrespektim të vërtetë ndaj tërë parimit të lejimit të njerëzve që të shprehin lirshëm vullnetin e tyre përmes votës. Nëse janë të pabaza, deklaramet e tilla të rrejshme do të rrezikojnë besimin publik në partitë politike.

Shoqëria Civile

Aktivitetet e shoqërisë civile në periudhën në mes të raundit të parë dhe të dytë të zgjedhjeve komunale duken të kenë pasur shumë pak ndikim në proces. Sikurse në raundin e parë, organizatat e shoqërisë civile i kanë mbajtur aktivitetet e tyre për vëzhgimin e zgjedhjeve, por me një intensitet shumë më të ulët. Disa organizata jo-qeveritare (OJQ) i kanë ndërprerë aktivitetet e tyre lidhur me zgjedhjet dhe nuk ka pasur aktivitet të dukshëm edukativ për votuesit për raundin e dytë.

Koalicioni “Demokracia në Veprim” ka qenë aktive në nivel lokal, duke vizituar komunat dhe duke dërguar porosi për zgjedhje të lira dhe të drejta. “Demokracia në Veprim” ka mbajtur një konferencë për shtyp një ditë para heshtjes zgjedhore, duke vlerësuar procesin pas raundit të parë. Koalicioni mbeti organizata me numrin më të madh të vëzhguesve të akredituar - 2393⁷, prej të cilëve 1448 janë caktuar në të gjitha komunat ku zgjedhjet për balotazh janë organizuar.

Si një rrjet ndërkombëtar i OJQ-ve, ENEMO ende ka përshtypjen e përgjithshme se shoqëria civile nuk është duke i adresuar çështjet e rëndësishme lidhur me këtë proces në masën e duhur dhe të pritur.

Pjesëmarrja e grave

Përkundër kornizës ligjore që promovon barazinë gjinore si “një vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë,”⁸ pjesëmarrja e grave në institucionet politike dhe shtetërore në Kosovë mbetet e kufizuar.

Të gjitha nga 11 kandidatet femra për kryetar komune janë mposhtur në raundin e parë, dhe në 21 garat e mbetura, garat kanë qenë në mes të 42 kandidatëve meshkuj. Administrimi zgjedhor ka vazhduar të tregoj një paragjykim të qartë të anëtarëve meshkuj të stafit pasi që vetëm 12% të anëtarëve të komisioneve të vend votimeve kanë qenë femra.

Rastet e shumta të votimit familjar (rastet janë vëzhguar në 26% të vend votimeve të vizituara në raundin e dytë) jo vetëm që janë kundër ligjit, por paraqesin një shkelje serioze të parimit të rëndësishëm të fshehtësisë së votës. Në përgjithësi, pranimi i dukshëm i kësaj shkelje nga autoritetet zgjedhore dhe vëzhguesit politik edhe më tej konsolidon traditën e përjashtimit të femrave nga roli aktiv në shoqëri.

Komunitetet

Në pajtim me qëllimet e planit të Ahtisarit, komunitetet e ndryshme në Kosovë kanë zgjedhur udhëheqësit e tyre në disa nga komunat ku zgjedhjet janë mbajtur për herë të parë. Partia Demokratike Turke e Kosovës (KDTP) ka siguruar pozitën e kryetarit të komunës dhe shumicën e anëtarëve të këshillit në Mamushë, ndërsa komuniteti i serbëve të Kosovës ka marrë kontrollin në Graçanicë, Ranillug, dhe Kllokot.

Në Shtërpcë dhe Novobërdë, rezultatet nga raundi i parë i zgjedhjeve nuk kanë qenë përfundimtare dhe të dy komunat kanë shkuar në balotazh. Informata preliminare për raundin e dytë duket të tregoj se ka pasur një rritje të konsiderueshme të votuesve në këto komuna.

Dita e Zgjedhjeve

Në Ditën e Zgjedhjeve, 106 vëzhgues janë caktuar të vëzhgojnë hapjen e vend votimeve, votimin, dhe procedurat e numërimit. Vëzhguesit kanë bërë gjithsej 538 vizita të vend votimeve në shumicën e 504 qendrave të votimit, dhe kanë përcjellë numërimin dhe transferimin e rezultateve në të gjitha KKZ0të. Vëzhguesit e ENEMO kanë plotësuar diku 640 formularë të vëzhgimit.

Në përgjithësi, zgjedhjet janë mbajtur në një atmosferë të qetë dhe përkundër kushteve më sfiduese atmosferike në krahasim me raundin e parë, autoritetet zgjedhore kanë arritur të zgjidhin të gjitha problemet logjistike dhe shumica e vend votimeve janë hapur me kohë ose

⁷ Burimi: www.kqz-ks.org

⁸ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 7

me vonesa shumë të vogla. Në krahasim me raundin e parë, një përmirësim i vogël në sjellje është vërejtur gjatë këtyre vizitave dhe procesi i votimit është vlerësuar pozitiv në 96 përqind të vend votimeve të vizituara dhe në përgjithësi vend votimet i janë përmbajtur procedurave të votimit; mirëpo, disa mangësi procedurale kanë mbetur. Në katër përqind të vend votimeve të vizituara, anëtarët e komisionit të vend votimeve nuk kanë kontrolluar gjithmonë në mënyrë të duhur për ngjyrë dhe në tre përqind të vend votimeve, dokumentet identifikuese të votuesve nuk janë kontrolluar gjithmonë, që ka rezultuar në mundësinë për votim të shumëfishtë dhe/ose të autorizuar

Fshehtësia e votës nuk është vëzhguar gjithmonë. Në veçanti, rastet e votimit grupor ose familjar ende janë vërejtur në 26 për qind të vend votimeve, votimi i autorizuar në gjashtë për qind, dhe tentimet për ndikimin e votuesve në diku tre për qind.

Përfaqësuesit e partive të dy kandidatëve garues në komunat përkatëse kanë qenë të pranishëm si anëtarë në KVV në 91 për qind të vend votimeve të vizituara nga vëzhguesit e ENEMO dhe në 81 për qind, partitë i kanë caktuar vëzhguesit. Vëzhguesit vendor kanë qenë të pranishëm në 87 për qind të vend votimeve të vizituara, më së shpeshti duke përfaqësuar Demokracinë në Veprim.

Vrojtimet nga procedurat e përmbylljes dhe numërimit japin përshtypjes se përpjekjet nga KQZ-ja për përmirësimin e procesit kanë pasur efekte pozitive. Numërimi në përgjithësi është bërë shpejt dhe në mënyrë efikase, dhe është vlerësuar pozitivisht në të gjitha vend votimet e vizituara përveç në njërin.

Mirëpo, rastet e izoluara të mos zbatimit të procedurave administrative janë vërejtur dhe në tri raste fletëvotimet nuk janë kontrolluar për vule në anën e prapme. Në dy raste, udhëheqësi i vend votimit nuk ka shpallur rezultatin e përkohshëm dhe, në gjashtë raste, një kopje e protokollit të rezultatit nuk është vendosur në hyrje të vend votimeve, sikurse kërkohet me ligj.

Problemet e shumta me materialin e dërguar në QNR në raundin e parë nuk janë vërejtur këtë herë në vend votimet e vizituara, dhe paketimi dhe mbyllja e materialit pas numërimit është vlerësuar nga të gjithë vëzhguesit të ketë qenë në pajtim të plotë me udhëzimet.

Vëzhguesit vendor kanë qenë të pranishëm në shumicën e vend votimeve të vizituara nga vëzhguesit e ENEMO gjatë numërimit dhe vëzhguesit ose përfaqësuesit e partive kanë qenë të pranishëm në të gjitha përveç në njërin nga to.

Procedura e pranimit në KKZ-të gjithashtu duket të ketë shkuar shumë më rrjedhshëm sesa në raundin e parë dhe është vlerësuar pozitivisht nga të gjithë vëzhguesit. Nga 798 vend votime të vëzhguara gjatë pranimit, diku nëntë për qind kishin gabime, kryesisht lidhur me zbrazëtitrat në Formularin e Rezultatit

dhe Bashkërendimit ose me mënyrën se si materiali është pakëtuar, por në përgjithësi, këto mangësi janë adresuar nga KKZ-të në koordinim me KVV-të.

Ankesat dhe Parashtresat

Për shkak të lirit të vonshëm të fondit qeverisës, Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (KZAP), sipas burimeve të KZAP-së, do të ketë numër të plotë të stafit dhe do të jetë funksional vetëm në fillim të janarit 2010. ueb faqja e KZAP-së ka qenë tërësisht funksionale vetëm në fazën e fundit të fushatës, dhe ende, shumë pak vendime janë përkthyer në gjuhën zyrtare serbe.

ENEMO do të vazhdojë të përcjell procesin e ankesave dhe parashtresave derisa rezultatet përfundimtare të certifikohen.

Misioni ENEMO dëshiron ti falënderohet Komisionit Qendror Zgjedhor dhe Shërbimit Policor të Kosovës (SHPK) për bashkëpunimin dhe ndihmën e tyre gjatë vëzhgimit. Misioni ENEMO gjithashtu i falënderohet Zyrës Ndërkombëtare Civile (ICO) për përkrahjen e tyre gjatë gjithë kohës.

ENEMO shfrytëzon rastin të shpreh mirënjohjen dhe falënderimet donatorëve të misionit për vëzhgim: USAID përmes Institutit Nacional Demokratik – NDI, Ambasada e Holandës, Ambasada e Republikës së Gjermanisë dhe Qeverisë së Suedisë.

Për informata të më tutjeshme, ju lutemi të kontaktoni **+386 49 206 473**

Ky dokument është në dispozicion në gjuhën shqipe dhe serbe, por vetëm versioni në gjuhën angleze mbetet zyrtar

Rrjeti Evropian i Organizatave për Monitorimin e Zgjedhjeve (ENEMO) është një grup i 22 organizatave udhëheqëse qytetare nga 17 vendet e Evropës lindore dhe qendrore dhe Azia qendrore. Organizatat anëtare të ENEMO kanë monitoruar më tepër se 140 zgjedhje kombëtare dhe kanë trajnuar më tepër se 190,000 vëzhgues. Qëllimi i ENEMO është të përkrah interesin e komunitetit ndërkombëtar në promovimin e demokracisë në regjionin në të cilën angazhohet, të vlerësoj proceset zgjedhore dhe mjedisin politik, dhe të ofroj raporte vëzhguese të sakta dhe të paanshme. Misionet ndërkombëtare vëzhguese të ENEMO vlerësojnë procesin zgjedhor duke përdorur standardet ndërkombëtare për zgjedhjet demokratike dhe standardet në legjisllacionin dhe kushtetutën e vendit të vlerësuar.

Pas marrjes së ftesës nga Kryetari i Republikës së Kosovës Dr. Fatmir Sejdiu për të vëzhguar Zgjedhjet Komunale 2009, me 12 tetor, 2009, Ekipi Kryesor i ENEMO ka arritur dhe është përgatitur të dërgoj 12 vëzhgues afatgjatë në 6 ekipe duke mbuluar tërë territorin e Kosovës për monitorimin e mjedisit para zgjedhor përfshirë fushatën parazgjedhor dhe aktivitetet e administrimit zgjedhor para 15 nëntorit. Në ditën e zgjedhjes, ENEMO ka dërguar 106 vëzhgues të zgjedhjeve në 644 vend votime, në të gjitha komunat e Kosovës ku zgjedhjet janë mbajtur.

Ekipi Kryesor dhe 12 Vëzhgues Afatgjatë kanë mbetur në Kosovë gjatë tërë periudhës së përkohshme dhe në Ditën e Zgjedhjeve me 13 dhjetor 106 Vëzhgues Afatshkurtë janë kthyer për të vizituar 538 vend votime në 21 komunat ku zgjedhjet për balotazh janë mbajtur.

Për këtë Mision Vëzhgues Zgjedhor vëzhguesit e ENEMO vijnë nga 16 organizata anëtare të ENEMO dhe 8 vende të ndryshme nga Evropa dhe Eurasia.

Raporti preliminar vëzhgues i ENEMO është i bazuar në vrojtimitet e gjetjeve të vëzhguesve afatgjatë dhe afatshkurtë lidhur me standardet ndërkombëtare dhe legjislacionin kombëtar të zgjedhjeve. Misioni thekson se raporti preliminar nuk paraqet një vlerësim përfundimtar të tërë procesit zgjedhor. ENEMO nuk do të dorëzoj vlerësimin përfundimtar deri në fund të procesit zgjedhor që përfshinë numërimin e votave, shpalljen e rezultateve, balotazhet e mundshme dhe ankesat e mundshme që do të adresohen. Raporti përfundimtar do të publikohet në janar 2010.